



Data: 11/09/2020 Ref.: 1569/20

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 83-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Ri/akreditoohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën pesë vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2025:
 - Juridik i Përgjithshëm (LLB), 240 ECTS, (me specializim: Kriminalistikë), maksimumi 320 student për vit akademik në Prishtinë, 80 studentë në Ferizaj, 80 studentë në Gjakovë);
 - Juridik Penal (LLM), 60 ECTS, maksimum 35 student për vit akademik
- II. Ri/akreditoohen programet e studimit të Kolegjit AAB për periudhën tri vjeçare, 1 Tetor 2020 – 30 Shtator 2023:
 - Menaxhment (MA), 120 ECTS, maksimum 200 student për vit akademik
 - Infermieri (BSc), 180 ECTS, maksimum 250 student për vit akademik
- III. Obligohet Kolegji AAB që deri me datë 31 tetor 2020 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji AAB ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit të cekura në dispozitiv I dhe II të këtij vendimi. AKA ka organizuar vizita të ndara në distancë të akreditimit me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB, me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit: Juridik i Përgjithshëm LLB (Prishtinë, Gjakovë, Ferizaj), Juridik Penal LLM, Menaxhment MA dhe Infermieri BSc.

Vizita e parë në distancë është realizuar me datë 30.06.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Helvi Kyngas dhe Delia Gologan. Vizita e dytë në distancë është realizuar me datë 07.07.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Tornike Khoshtaria dhe Peter Parycek. Ndërsa vizita e tretë në distancë është realizuar me datë 08.07.2020 me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Peter Parycek, Goce Naumkovski dhe Marija Vasilevska.

Sipas ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, programet e studimit të përmendura në dispozitivin I dhe II të këtij vendimi përmbushin substancialisht standardet e akreditimit të përcaktuara në Manualin e Akreditimit dhe rrjedhimisht kanë rekomanduar ri/akreditimin e tyre. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2020 ka shqyrtuar aplikacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB;
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar, Këshilli Shtetëror të Cilësisë